



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 4 mars 2013  
Nr. ref.:APGT390/13

Në bazë të nenit 11.1 (1.4) të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, të 15 janarit 2009, dhe në bazë të rregullit 61 (1.1) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, e 14 dhjetorit 2012), me qëllim të përmirësimit të gabimeve teknike në Aktvendimin për papranueshmëri për rastin KI81/10, të 15 shtatorit 2012, Gjykata Kushtetuese, *ex officio*, më 4 mars 2013, merr:

### AKTVENDIM

PËR PËRMIRËSIMIN E GABIMEVE TEKNIKE NË AKTVENDIMIN PËR PAPANUESHMËRI, TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, PËR RASTIN KI81/10, TË 15 SHTATORIT 2012

- I. **PËRMIRËSOHET** Aktvendimi për papranueshmëri, për rastin KI81/10, i 15 shtatorit 2012, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, ashtu që, në paragrafin 1, emri i parashtruesit të kërkesës shkruhet z. NAZIF REKA, në vend të emrit Ramadan Rrahmani.
- II. **PËRMIRËSOHET** Aktvendimi për papranueshmëri, për rastin KI81/10, i 15 shtatorit 2012, në paragrafin 13, ashtu që, në rreshtin e tretë FSHIHET tërësisht shprehja “e apelit”, e cila është e radhitur pas tekstit “Gjykatën Komunale si dhe Gjykatën e Qarkut në Prishtinë”.
- III. **PËRMIRËSIMET** e bëra sipas këtij aktvendimi vlejné për të tri versionet gjuhësore të Aktvendimit për papranueshmëri, për rastin KI81/10, të 15 shtatorit 2012, ndërsa pjesa e tjetër e tekstit të Aktvendimit për papranueshmëri, për rastin KI81/10, të 15 shtatorit 2012, mbetet e pandryshuar dhe mbetet në fuqi.
- IV. Ky aktvendim është pjesë përbërëse e Aktvendimit për papranueshmëri, për rastin KI81/10, të 15 shtatorit 2012, dhe bëhet publik, si dhe u komunikohet palëve në mënyrë të njëjtë sikurse edhe në Aktvendimin për papranueshmëri, për rastin KI81/10, të 15 shtatorit 2012.

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, me qëllim që teksti i Aktvendimit për papranueshmëri, për rastin KI81/10, të 15 shtatorit 2012, të reflektojë në tërësi vendimin meritor të kësaj gjykate përkitazi me kërkesën e parashtruar nga pala e autorizuar dhe për të evituar paqartësitë e mundshme që mund të shfaqen si pasojë e gabimeve teknike të publikuara në Aktvendimin për papranueshmëri, për rastin KI81/10, të 15 shtatorit 2012, në pajtim me nenin 113 të Kushtetutës dhe në pajtim me rregullin 61 (1.1) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 4 mars 2013, njëzëri

## VENDOSI

- I. TË APROVOJË *EX OFFICIO* përmirësimet në Aktvendimin për papranueshmëri, për rastin KI81/10, e 15 shtatorit 2012;
- II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe,
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Prof. dr. Enver Hasani

